



PULSAR – KPRF & KPE


RAPORTIMI FINANCIAR DHE KONSOLIDIMI NË KOHËN E COVID-19


Lívia Shinn Straková - Ekipi për SEKSP-të, EUROSTAT

7 korrik 2020

Përmbajtja

- Kundërpërgjigjja e BE-së ndaj COVID-19, prezantim i përgjithshëm
- Kontabiliteti shtetëror dhe SEKSP-të
- Përvojat e Shteteve Anëtare të BE-së
- Përfitimet nga kontabiliteti i harmonizuar me të drejta dhe detyrime të konstatuara





EU CORONAVIRUS RESPONSE

#CORONAVIRUS



European Commission

Kontabiliteti shtetëror, SEKSP-të dhe mbështetja për kundërpërgjigjen ndaj COVID-19 – studim i hartuar nga PwC

- Nevoja për informacione cilësore për të siguruar politikë-bërje dhe planifikim financiar efektiv.
- Rritja e transparencës është tipar kryesor i llogaridhënies demokratike.
- Nevoja jetike për informacione të besueshme për të rifituar besimin në këto kohë të paqarta, kryesisht nëpërmjet raportimit financiar.
- Shumë qeveri kanë shpallur tashmë masa për të dhënë ndihmë financiare dhe jofinanciare.
- Nevojë e madhe për të siguruar përdorimin e duhur të fondeve të shpenzuara dhe për të vlerësuar efektivitetin e masave të marra.

Llojet kryesore të programeve publike në kundërpërgjigje të krizës së COVID-19

Shpenzime të drejtpërdrejta shtetërore

- Rritja e mundësisë për të marrë pagesa sociale [mbështetje me të ardhura, asistencë papunësie]
- Kufizimi i përhapjes së COVID-19 nëpërmjet testeve, sigurimi i pajisjeve mbrojtëse

Masa të lidhura me tatim-taksat

- Shtyrje të afateve të pagimit të tatim-taksave dhe masa të ngjashme

Mbështetje për bizneset

- Grante
- Kredi (me kushte të favorshme)
- Investime në kapitalin neto ose të ngjashme
- Skema të garantimit publik

Mbështetje për sistemet financiare

- Riblerja e obligacioneve dhe e letrave të tjera me vlerë të mbështetura në aktive
- Ulje e normave të interesit

Përvojat e Shteteve Anëtare të BE-së - I

- **Rritja e pagesave të papunësisë** – Disa vende kanë marrë masa për ta zgjeruar dhe rritur përfitimin nga programi i pagesave të papunësisë.
- **Mbështetje për të ardhurat nëpërmjet subvencioneve të pagave, të kanalizuar ose jo nëpërmjet punëdhënësve** – Mbështetje për punëdhënësit e prekur negativisht nga COVID-19.

Kuadri i harmonizuar i kontabilitetit në sektorin publik për dërgesat në para dhe për pagesat e tjera sociale në kuadër të zbutjes së risqeve sociale (si risku i papunësisë për shkak të masave bllokuese nga COVID-19) mundëson raportim të njëtrajtshëm të shumave të mëdha të shpenzimeve shtetërore nga ana e Shteteve Anëtare. Të dhënat e njëtrajtshme mund të shpjegojnë edhe karakteristikat e skemave të pagesave sociale dhe faktorët e tjerë demografikë, ekonomikë dhe të jashtëm që mund të ndikojnë në këto skema. Për të vlerësuar efektivitetin e këtyre masave dhe për të mbajtur në kontroll shpenzimet shtetërore dhe deficitin, qeverive u duhet një kuadër raportimi i cili mbulon dhe mat të dhënat përkatëse financiare dhe jofinanciare.

Përvojat e Shteteve Anëtare të BE-së - II

- **Masat e lidhura me tatim-taksat** – Në shumicën e vendeve, bizneseve u janë miratuar shtyrje të përkohshme të afatit për deklarimin dhe pagimin e tatimeve.

Tatim-taksat janë burimi kryesor i të ardhurave për shumë qeveri, prandaj duhet matur dhe administruar ndikimi që kanë masat lehtësuese fiskale në deficitin shtetëror. Qeveritë kanë nevojë më shumë se kurrë për të dhëna të besueshme për të njohur të ardhurat në periudhën e duhur kontabël, për t'i matur në mënyrë korrekte dhe për të ruajtur kontrollin mbi një burim të rëndësishëm financimi. Praktikë cilësore të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara orientojnë se kur duhen njohur të ardhurat dhe në çfarë sasive. Duke qenë se kriza e COVID-19 dhe masat e lidhura shtetërore kanë një ndikim të madh negativ mbi burimet e të ardhurave fiskale (TVSH, TAP dhe tatim-fitimi) është me rëndësi të raportohen në mënyrë transparente dhe të krahasueshme. Kjo do të mundësonte edhe parashikimet sa i takon rikuperimit të të drejtave të kërkueshme tatimore në kushtet ekzistuese ekonomike.

Përvojat e Shteteve Anëtare të BE-së - III

- **Grantet** – Shumë qeveri u kanë dhënë grante disa përfituesve të përzgjedhur për të mbështetur individët, të vetëpunësuarit dhe bizneset. Këto masa kanë një ndikim në buxhet i cili mund të shtrihet në disa vjet.
- **Kredi (me kushte të favorshme)** – Komisioni Evropian por edhe Shtetet Anëtare mund të japin ndihmë financiare në formën e kredive të dhëna me kushte të favorshme bizneseve.

Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara reflekton të drejtat dhe detyrimet e secilës palë sipas kontratës së grantit, çka rrit transparencën dhe llogaridhënien. Nga kjo përmirësohet edhe administrimi i rikuperimit. Qeveritë duhet të vlerësojnë risqet e kredive që shoqërojnë kreditë e dhëna individëve ose shoqërive dhe çdo suficit ose humbje e mundshme e kredive duhet të reflektohet në pasqyrat financiare. Një informacion i tillë mund të përdoret edhe për vendimmarrjen strategjike, monitorimin dhe mbikëqyrjen në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së.

Përfitimet nga kontabiliteti i harmonizuar me të drejta dhe detyrime të konstatuara - I

- ✓ Dhënia e informacioneve aktuale dhe të besueshme të cilat mund të përdoren për të vlerësuar arritjen e objektivit të realizimit të shërbimeve nga qeveria.
- ✓ Administrimi optimal i aktiveve përmes raportimit të tyre në pasqyrën e bilancit i shtyn qeveritë të marrin vendime të ndërgjegjshme për përdorimin më të mirë të këtyre mjeteve.
- ✓ Raportimi i gjithanshëm i detyrimeve shtetërore (afatgjata), duke reflektuar përmbajtjen e veprimeve dhe i risqeve që shoqërojnë këto detyrime kontribuon kështu në vlerësimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike.
- ✓ Raportimi i plotë dhe në kohën e duhur i të ardhurave fiskale, që është edhe një element kyç për vlerësimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike.

Përfitimet nga kontabiliteti i harmonizuar me të drejta dhe detyrime të konstatuara - II

- ✓ Raportimi se si dhe deri ku grantet e dhëna janë përdorur me efektivitet nga përdoruesi, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien.
- ✓ Raportimi dhe matja e duhur e risqeve të lidhura me dorëzanitë financiare të dhëna.
- ✓ Raportimi i rrjedhëve financiare të investimeve në kapitalin neto, në bazë të nivelit të kontrollit të fituar mbi njësinë ekonomike ku ka investuar qeveria.
- ✓ Raportimi i pasojave financiare të dhënies së kredive një larmie palësh interesi, me gjasë me kushte të favorshme.
- ✓ Nxitja e debatit politik mes vendimmarrësve lidhur me ndikimin financiar afatgjatë të politikave sociale, mjedisore dhe të tjera të cilat duhet të vihen në zbatim, duke futur kështu në thelb të vendimeve politike elementin e drejtësisë midis brezave.

Komunikimi

Kontabiliteti shtetëror, SEKSP-të dhe mbështetja për kundërpërgjigjen ndaj COVID-19:

<https://ec.europa.eu/eurostat/web/epsas/key-documents/analyses>

Komisioni Evropian – Eurostat – SEKSP:

<https://ec.europa.eu/eurostat/web/epsas/>

Arkiva CIRCABC:

<https://circabc.europa.eu/w/browse/18db61bc-6649-44b3-af14-17fcd1c1216c>

Qëndroni të informuar – ndiqni mediat sociale:



[@EU_Eurostat](https://twitter.com/EU_Eurostat)



[@EurostatStatistics](https://www.facebook.com/EurostatStatistics)



[@EU_Eurostat](https://www.instagram.com/EU_Eurostat)

Faleminderit



© Bashkimi Evropian 2020

Nëse nuk thuhet ndryshe, ripërdorimi i këtij prezantimi lejohet sipas lejes [CC BY 4.0](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/) . Për çdo përdorim ose riprodhim të elementeve të cilat nuk janë pronësi e BE-së, mund të jetë e nevojshme të kërkohet leje drejtpërdrejt nga mbajtësit përkatës së të drejtës.

